



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 491/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, me datë 03.11.2013, në ora 14:39, në Serbicë të Poshtme një grup militantësh të subjektit politik PDK, po bëjnë presion ndaj votuesve duke qëndruar te dera e shkollës. Më tutje ka shtuar se ata po shpërndajnë materialin me përmbajtje propagandistike për kandidatin nga radhët e PDK-së.

Për më tepër ka shtuar se këto veprime janë të kryera nga një person ashtu siç shihet në foto, Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimi i tillë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 34.2 të LZP-së. Me propozim që subjektit politik PDK ti shqiptohet dënimi sipas ligjit në fuqi

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 491/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*